



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

P/VENDIM

Nr. _____ dt ____/____/2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE NË
BASHKINË PËRMET**

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën ____/____/2022 në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, Ligjit nr 107/2014 date 31.07.2014 “Per Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimit nr 3 date 10.06.2020 te KKT “Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Përmet”, VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbeteve dhe të Planit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve", Vendim Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", Vendim Nr. 319, Datë 31.5.2018 Për Miratimin e masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, vendim Nr. 660, Datë 31.10.2018 “Për miratimin e kerkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve”, Vendim Nr. 418, Datë 27.5.2020 Për Miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Zyra e Shërbimeve Publike dhe Sektori i Pastrim-Gjelberimit dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

- 1- Të miratojë Rregulloren për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Përmet sipas Draftit bashkëlidhur këtij Vendimi dhe është pjese përbërëse e tij.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës/Planifikimit të Territorit/Pastrim Gjelbërimit dhe e Mirëmbajtjes, Drejtoria e Financë-Buxhetit-Taksa Tregje, Policia Bashkiake.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA**